



Nr. 02/2023
Data:18.08.2023

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN E KONSUMATORËVE FAMILJARË NË INVESTIMIN NË SISTEME TË ENERJISË SË RIPËRTËRITSHME - Sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar

Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit vendor të energjisë elektrike, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar kanë krijuar pasiguri në furnizimin me energji elektrike. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonominë familjare si dhe për bizneset.

Sipas statistikave, konsumatori më i madh i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është sektori rezidencial, i cili kontribuon rreth dyzet përqind (40%) në konsumin final të saj. Ulja e konsumit përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE) ndikon në reduktimin e kërkesës për energji elektrike duke ndihmuar familjet për të reduktuar faturat e energjisë e elektrike, por edhe për mirësuar sigurinë e furnizimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji, ka ndërmarr masa konkrete në adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit¹ Nr. 29/112, datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin² Nr.03/128, datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitimin e mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023. Ky Plan parasheh zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurtra për periudhën e dimrit, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social, nxitjen e kursimit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Efiçencës së Energjisë (EE) në njësitë e banimit dhe të ndërtesave si dhe investimeve në pajisje efiçente për ngrohje, pajisjeve elektro-shtëpiake efiçente dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për konsumatorët

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

familjarë.

Bazuar në Masën katër (4) të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë, në veçanti konsumatorët në nevojë në investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme - Sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova- Republic of Kosovo
 Qeveria-Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
 the European Union

1 SISTEMET TË CILAT DO TË SUBVENCIONOHEN PËR KONSUMATORËT FAMILJARË

- ✓ Instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar

Subvencionohet vetëm një (1) sistem diellor për ngrohjen e ujit sanitar për një (1) shtëpi dhe sistemi duhet të blihet i ri.

Vërejtje: Nëse aplikoni për këtë masë, ju nuk keni të drejtë të përfitoni nga subvencionimi për masën “Instalimi i sistemit fotovoltaik (FV) për prodhimin e energjisë elektrike” e cila do të lansohet më vonë.

2 KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shpesh për sistemin që do të subvencionohet.

SISTEMI	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
Instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e	a. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë konsumatorët familjar, konsumi mujor i energjisë elektrike i të cilëve nuk është më i vogël se 250 kWh/ në të paktën dhjetë (10) muaj brenda dymbëdhjetë (12) muajve të	<u>A. Panelet diellore termike</u> (panel diellor me tuba të vakumuar, ose panel diellor të rrafshët) a. Kriteret obligative:	Subvencionohet dyzet për qind (40%) e vlerës investive të komplet sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar dhe jo më	Me sistem diellor nënkuptohet: (i) Panelet diellore; (ii) akumuluesi i nxehtësisë /bojleri për ujë sanitar, dhe (iii) tubacioni lidhës mes



ujit sanitar³	fundit ⁴ .	<ul style="list-style-type: none">▪ E pajisur me etiketën e konformitetit CE;▪ Efikasiteti termik $\eta \geq 56\%$ ose eficiencë me zero-humbje > 0.75 <p>b. Kriteret e rekomandueshme:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Absorbimi $>$ nëntëdhjetë (90);▪ I konstruktuar me cilësi të lartë, rezistente ndaj goditjeve, duke përdorur qelqin diellor rezistent ndaj goditjes, anti-reflektues;▪ Tubi i absorbuesit nga bakri, me portet për sensorët e temperaturës dhe çajrosjes së panelit;▪ Koeficienti termik $k1 > 3.8 \text{ W/m}^2\text{K}$;	shumë se 1000.00 € .	paneleve dhe akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit dhe moduli bashkë me pompën riqarkulluese dhe automatikën/senzorët e temperaturave. Bazuar në informatat nga etiketat e prodhuesve, rekomandohet që raporti i sipërfaqes së panelit diellor/ kapaciteti i akumuluesit të nxehtësisë (bojlerit) të jetë një metër kub (1m²) i panelit diellor për pesëdhjetë (50)-shtatëdhjetë e pesë (75) litra të akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit.
---------------------------------	-----------------------	--	-----------------------------	---

³ Për shkak të kursimit më të madh të energjisë, termoizolimi si masë paraprake është gjithmonë i rekomandueshëm.

⁴ Në formularin për aplikim online e-Kosova, aplikantit do t'i kërkohej të shënojë shifrën e konsumatorit të faturës së energjisë elektrike (sipas faturës së KESCO), dhe përmes shifrës së konsumatorit nga kompania KESCO do të merren informatat mbi shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike. Vlera minimale e konsumit të energjisë elektrike 250 kWh/muaj kërkohej si dëshmi që ndërtesa është e banuar.



		<ul style="list-style-type: none">▪ Koeficienti i ngrohjes $k_2 > 0.001 \text{ W / m}^2\text{K}^2$;▪ Izolim R10 pllakë shkume poli-isocyanate ose lesh mineral me përçueshmëri termike 0.035W/mK;▪ I përshtatshëm për instalim sipas DIN 1988, EN 12828 i DIN 4753.▪ Temperatura e stagnimit $< 200 \text{ }^\circ\text{C}$;▪ Presioni Max. punues dhjetë (10) bar▪ Mediumi për transferim të nxehtësisë Glykol. <p><u>B. Akumulues të nxehtësisë / bojler</u></p> <p><i>a. Kriteret obligative:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Kapaciteti – vëllimi i akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit prej 150L e më lartë, sipas nevojave për ujë të ngrohtë;		
--	--	---	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

		<ul style="list-style-type: none">▪ Klasa energjetike të jetë minimum “C”;▪ E pajisur me etiketën e konformitetit CE. <p><u>C. Moduli i pompimit</u></p> <p><i>a. Kriteret obligative:</i></p> <ul style="list-style-type: none">▪ Klasa energjetike të jetë minimum “B”;▪ E pajisur me etiketën e konformitetit CE.		
--	--	---	--	--



3 MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim është e ndarë në dy (2) faza dhe në të dy (2) fazat aplikimi bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Hapat për aplikim

Faza I

1. Sigurohuni që plotësoni kriterin për aplikim në lidhje me konsumin e energjisë elektrike këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/468>
2. Shkarkoni dhe plotësoni formularin për aplikim “Shtojca 1” nga platforma e-Kosova në linkun më lart;
3. Plotësoni të dhënat e kërkuara në platformën e-Kosova dhe ngarko formularin “Shtojca 1” në linkun më lart.

Pas verifikimit nga komisioni se formulari është plotësuar konform kriterëve, në një (1) afat kohor prej jo më larg se pesë (5) ditë pune nga data e aplikimit, ju do të njoftoheni se jeni kualifikuar për këtë fazë dhe mund të vazhdoni me instalimin e sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar, sipas kriterëve teknike të specifikuara në thirrje.

Linkun për aplikim në fazën e dytë do ta pranoni në email adresën me të cilën e keni hapur llogarinë e juaj në e-Kosova.

Faza II

Pas instalimit të sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar, sipas kriterëve të specifikuara në thirrje, ju duhet të aplikoni për fazën II përmes platformës e-Kosova që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke ngarkuar dokumentet si në vijim:

1. Faturën e rregullt me dëshmi të pagesës përmes transferit bankar apo kuponin fiskal të blerjes së sistemit (data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më 18.08.2023);
2. Fotografitë e instalimit të sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar (paneli, akumuluesi i nxehtësisë/bojleri, pompa);
3. Fotografitë e etiketave që përmbajnë karakteristikat teknike të pajisjeve përfshirë numrin serik (paneli, akumuluesi i nxehtësisë/bojleri, pompa);
4. Fotografitë e certifikatave së konformitetit CE të pajisjeve (paneli, bojleri, pompa);
5. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht në platformën e-Kosova. Kjo marrëveshje duhet patjetër të shkarkohet, **të nënshkruhet**, dhe të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhirollogarisë tuaj bankare e cila duhet të jetë në emër të aplikuesit dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lartë në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen: “Aplikimi juaj është realizuar me sukses. Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), i cili do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kriterëve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”.

Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencioni në xhirollogarinë tuaj.

Sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar, duhet të jetë i instaluar dhe i gatshëm për inspektim nga momenti që aplikoni për fazën e dytë.

Afati për aplikim


Afati i fundit për aplikim për fazën e parë është deri më datën **17 shtator të vitit 2023**. Nga momenti që aplikoni për fazën e parë, ju duhet të instaloni sistemin diellor për ngrohjen e ujit sanitar brenda periudhës gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike, pas kësaj periudhe aplikacioni juaj konsiderohet jovalid.

Afati i fundit për fazën e dytë është deri më datën **17 nëntor të vitit 2023**.

E drejta për ankesë

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: **komisioni.ankesa@rks-gov.net**

Sqarime shtesë

Për më shumë informacione dhe sqarime shtesë rreth fazave të aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën:  **info.subvencionet@rks-gov.net** apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

 038 200 215 89

 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00



Shtojca 1: Formulari i aplikimit (plotësohet me ndihmën e kompanisë instaluese)

Të dhënat e aplikuesit (të dhënat për aplikuesin duhet të jenë të njëjta me të dhënat që keni plotësuar dhe aplikuar në platformën e-Kosova)	
Emri	
Mbiemri	
Nr. Personal	
Adresa e shtëpisë	
Telefoni	
E-mail	
Të dhënat e sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar	
Lloji i paneleve diellore:	<input type="checkbox"/> panel me tuba të vakumuar <input type="checkbox"/> panel të rrafshët
Numri i paneleve:	_____ copë
Sipërfaqja totale e paneleve diellore:	_____ m ²
Kapaciteti i vëllimit të akumuluesit të nxehtësisë/bojlerit:	_____ litra
Kostoja totale e vlerësuar sipas ofertës për sistemin diellor për ngrohjen e ujit sanitar:	_____ Euro
Implementuesi dhe deklarata mbi standardet teknike	
Emri i biznesit instalues	
Numri i biznesit instalues (NUI)	
E-mail adresa	
Numri i telefonit	
Kriteret minimale të kërkuara	
Të dhënat për pajisjet:	Kriteri minimal i kërkuar (shëno me X nëse përmbushet kriteri)
<u>Paneli diellor:</u> Modeli: _____ Prodhuesi: _____	<input type="checkbox"/> Efikasiteti termik $\eta \geq 56\%$ ose efikasiteti me zero-humbje > 0.75 <input type="checkbox"/> Të pajisur me etiketën e konformitetit CE
<u>Akumuluesi i nxehtësisë/bojler:</u> Modeli: _____	<input type="checkbox"/> Klasa energjetike minimum "C" <input type="checkbox"/> Të pajisur me etiketën e konformitetit CE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova- Republic of Kosovo
 Qeveria-Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
 the European Union

Prodhuesi: _____	
<u>Moduli i pompimit:</u> Modeli: _____	<input type="checkbox"/> Klasa energjetike minimum “B”
Prodhuesi: _____	<input type="checkbox"/> Të pajisur me etiketën e konformitetit CE
Deklaroj se projekti: Instalimi i sistemit diellor për ngrohjen e ujit sanitar i përmbush të gjitha Standardet Teknike sipas thirrjes Nr. 02/2023 të datës 18.08.2023.	<i>Emri dhe mbiemri, Nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania furnizuese/instaluese dhe vula</i>

Plotësimi i këtij formulari nënkupton autorizimin e institucionit që të përdorë të dhënat e përfshira në të për qëllime të këtij projekti!

Vërejtje: Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Neni 299 - Mashtrimi i blerësve “1. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pësja apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Emri dhe mbiemri i aplikuesit: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____ **Vendi:** _____